

**Emri i Lëndës : E Folura në Publik**

Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 304	C	Semestri i Verës	3.00	0.00	0.00	3.00	6.00

<b>Lektori</b>	Ramadan Cipuri, Prof. Asoc. Dr.
<b>Asistenti</b>	
<b>Gjuha e kursit</b>	Shqip
<b>Niveli i lëndës</b>	Bachelor
<b>Përshkrimi</b>	Gjatë gjithë historisë së njerëzimit njerëzit e kanë përdorur të folurin në publik si një mënyrë vitale komunikimi. Të folurit në publik është një mënyrë e bërjes publike të ideve; e ndarjes së këtyre ideve me njerëzit e tjerë dhe një mënyrë e ndikimit të individëve. Në kurs do të flitet për artin e të folurit në publik dhe do të analizohen të gjithë faktorët që ndikojnë në përgatitjen dhe mbajtjen e një fjalimi të mirë para publikut. Që një komunikim i tillë të jetë efikas, duhen njohur mirë elementet që përfshihen gjatë një ndërveprimi të tillë. Analiza e audiencës, puna kërkimore paraprake, zgjedhja e temës, hartimi i fjalimit në mënyrë të strukturuar, mposhtja e etheve të skenës dhe arti i të bindurit janë disa nga çështjet që do të trajtojmë së bashku.
<b>Objektivat</b>	Në fund të kësaj lënde, studenti do të jetë i familjarizuar me paraqitjen e një ligjërate të mirëargumentuar dhe mirëprezantuar, të përshtatshme me situatën përkatëse. Për të bërë këtë, do të përqëndrohet në disa aspekte si: Çfarë do të thotë të jesh një folës dhe dëgjues etik i mesazheve? Identifikimi i elementeve qëndrorë për një mesazh logjik dhe të mirëorganizuar; Identifikimi dhe prezantimi i llojeve të ndryshme të ligjëratave etj
<b>Konceptet Kryesore</b>	

**Programi i Lëndës**

Java	Tema
<b>1</b>	Hyrje në artin e të folurit në publik; Tradita e folurit në publik; Ngjashmëritë dhe dallimet midis të folurit në publik dhe bisedimit- Të folurit publik dhe mendimi kritik.
<b>2</b>	Analiza e audiencës; Fokusimi te audience; Psikologjia e audiencës; Analiza demografike e audiencës; Analiza e audiencës sipas situatës; Marrja e informacioneve mbi audiencën
<b>3</b>	Zgjedhja e një teme dhe qëllimi; Zgjedhja e një teme; Përcaktimi i qëllimit të përgjithshëm dhe specifik; Formulimi i idesë kryesore
<b>4</b>	Etika dhe të folurit në publik; Rëndësia e etikës; Këshilla për të folurit etik; Plagjiatura; Këshilla për dëgjimin etik Dëgjimi; Dëgjimi dhe të menduarit kritik; Shkaqet e dëgjimit të dobët
<b>5</b>	Mbledhja e materialeve; Përdorimi i njohurive dhe i përvojave vetjake; Kërkimi në bibliotekë; Kërkimi në internet; Intervista; Këshilla për punën kërkimore
<b>6</b>	Organizimi i pjesës kryesore të fjalimit- Pikat kryesore- Materialet mbështetëse
<b>7</b>	Fillimi dhe fundi i fjalimit; Hyrja; Konkluzioni; Skicimi i fjalimit; Skica e përgatitjes; Skica e mbajtjes së fjalimit
<b>8</b>	Përdorimi i gjuhës; Kuptimi i fjalëve; Përdorimi i saktë dhe i qartë i fjalëve; Përdorimi i përshtatshëm i gjuhës
<b>9</b>	Mbajtja e fjalimit; Metodat e mbajtjes së fjalimit; Zëri i folësit; Trupi i folësit
<b>10</b>	Përdorimi i mjeteve ndihmëse pamore; Llojet e mjeteve ndihmëse pamore; Përdorimi i Power Point-it
<b>11</b>	Llojet e fjalimeve; Të flasësh për të informuar; Të flasësh për të bindur

<b>12</b>	Metodat e bindjes; Ndërtimi i besueshmërisë; Përdorimi i evidencës; Arsyetimi; Tërheqja emocionale (patosi)
<b>13</b>	Fjalimet për raste të veçanta; Fjalime prezantuese; Fjalime dorëzimi të një vlerësimi publik; Fjalime pranimi të një vlerësimi publik; Fjalime përkujtimore; Fjalimet e pasdarkave
<b>14</b>	Fjalimet në grupe të vogla; Çfarë është një grup i vogël?; Udhëheqja dhe përgjësiti në grupe të vogla; Metodat e mendimit reflektues; Prezantimi i mendimeve të grupit
<b>15</b>	Përsëritje, prezantim i projekteve studentore
<b>16</b>	Provim Final
<b>Parakushtet</b>	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
<b>Literatura</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lucas E., Stephen; Arti i të folurit në publik, UET Press, Tirana, 2011</li> <li>• Vehbiu, Ardian; Shqipja totalitare - Tipare të ligjërimit publik në Shqipërinë e viteve 1945-1990; Botimet Çabej; Tirana 2007</li> </ul>
<b>Referenca të tjera</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sprague, Jo; Stuart, Douglas; The speaker's compact handbook; Wadsworth Centage Learning, 2010</li> <li>• Public Speaking and presentations; The MC-Graw - Hill Companies; 2010</li> </ul>
<b>Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat</b>	
<b>1</b>	Studentët do të përvetësojnë njohuri mbi paraqitjen e një ligjërate të mirëargumentuar dhe mirëprezantuar, të përshtatshme me situatën përkatëse.
<b>2</b>	Studentët do të zhvillojnë mendimin kritik mbi perceptimin e mesazhit të shpërndarë dhe analizimin e audiencës para dhe pas ligjërimit publik
<b>3</b>	Studentët do të jenë në gjendje të identifikojnë elementët qendrorë për një mesazh logjik

<b>Mënyra e Vlerësimit të Lëndës</b>			
<b>Notat e Ndërmjetme</b>	<b>Sasia</b>	<b>Përqindja</b>	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrare	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
<b>Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final</b>		<b>40</b>	
<b>Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final</b>		<b>60</b>	
<b>Total</b>		<b>100</b>	
<b>Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)</b>			
<b>Aktivitetet</b>	<b>Sasia</b>	<b>Kohëzgjatja (orë)</b>	<b>Ngarkesa Totale (orë)</b>
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	30	30
Provimi final	1	45	45
Të tjera	0	0	0
<b>Ngarkesa totale e orëve</b>			<b>151</b>
<b>Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)</b>			<b>6.04</b>
<b>ECTS</b>			<b>6.00</b>